



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226505
Datë: 21.06.2023
Numri i dokumentit: 04414989
Dosja fizike: C-IV-15-0918

N Sh
I përfaqësuar sipas autorizimit nga B I avokat nga Prishtina

Paditësja

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë

E paditura

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 21.06.2023, mori këtë:

AKTVENDIM

I. Konsiderohet e tërhequr padia e paditëses N Sh e paraqitur me datën 27.07.2015, kundër të paditurës Agjencia Kosovare të Privatizimit, me të cilën ka kërkuar rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore "Barnatoret e Prishtinës" (në Likuidim), PRN068-0056, të datës 02.07.2015, për arsye se paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datën 27.07.2015, paditësi ka paraqitur ankesë pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (në vazhdim: AKP), me të cilën ka kërkuar rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore "Barnatoret e Prishtinës" (në Likuidim), PRN068-0056, të datës 02.07.2015, dhe njohjen e të drejtës në kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 2,641.10 €, për periudhë të pacaktuar kohore.

Pala paditëse e ka titulluar parashtresën si “*ankesë*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi, konform nenit 35.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pran Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Me paraqitjen e padisë, paditësja nuk e ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk e ka dorëzuar dëshminë e pagesës së saj.

Me datën 10.10.2021, gjykata ka lëshuar urdhër për palën paditëse për të paguar taksën gjyqësore në shumën prej 20.00 €, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhëresës, me vërejtjen se nëse nuk kryhet pagesa brenda afatit të caktuar, gjykata do të marrë vendim me të cilin padinë do ta konsiderojë si të tërhequr. Nga fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës shihet se urdhri në fjalë i është dorëzuar përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, me datën 14.10.2022. Megjithatë, pala paditëse nuk e ka paguar shumën e caktuar në emër të taksës gjyqësore dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi të pagesës së saj.

Arsyetimi ligjor

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj primar. Përveç kësaj, si ligj procedural sekondarë zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006). Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se “*në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozitë përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore*”.

Detyrimi për pagesën e taksës gjyqësore është detyrim themelor i palës, për të ushtruar të drejtën e ndjekjes së një procesi gjyqësor pran Dhomës së Posaçme, i cili detyrim duhet të përmbushet bashkë me hapjen e rastit në gjykatë, respektivisht bashkë me dorëzimin e padisë.

Me nenin 253.4 të Ligji për Procedurën Kontestimore (në vazhdim: LPK), është përcaktuar se paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar. Ndërsa, me nenin 253.5 të LPK-së është përcaktuar se “*në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr*”.

Urdhri i kësaj gjykate për pagesën e taksës gjyqësore, e datës 10.10.2022, është mbështetur në dispozitat e lartpërmendura ligjore dhe në dispozitat tjera të ndërlydhura, si dhe në Udhëzimin Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, nr. 01/2017.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartëcekura dhe në dispozitat ligjore e nënligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet gjyqësore

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se “*Nëse pala e suksesshme nuk i kërkon shpenzimet ose nëse ashtu vendos Dhoma e Posaçme, atëherë secila palë i bartë shpenzimet e veta*”. Në këtë rast gjyqësor, asnjëra nga palët në procedurë nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale. Prandaj, gjykata ka vendosur që secila palë do të bartë shpenzimet e veta.

Udhëzimi juridik

Kundër këtij aktvendimi, mund të parashtrohet ankesë me shkrim pranë Dhomës së Posaçme, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij, e cila i drejtohet Kolegjit të Apelit pranë Dhomës së Posaçme, konform nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari,
Mr.sc. Bajram Miftari